



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës,

Në pajtim me nenin 5, paragrafin 5.4 pika (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19 mbi Degën e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë,

Duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat,

Me qëllim që të informohen të gjitha autoritetet publike duke përfshirë këtu: Autoritetin ekzekutiv qendror, regjional, komunal ose lokal, organin publik, ministrinë, departamentin, agjensionet ekzekutive, pushtetin ekzekutiv, legjislativ, gjyqësor, ndërmarrjet (subjektet personale afariste, ortakëritë, ndërmarrjet e përbashkëta, personat juridik etj), si dhe çdo organ apo organizatë tjetër e themeluar në bazë të drejtës publike, nxjerr këtë:

MEMORANDUM SHPJEGUES PUBLIK PËR JO-REZIDENTËT

SË BASHKU NË ZBATIM TË LIGJIT !

Sipas Ligjit Nr. 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, Administrata Tatimore e Kosovës është Agjencion Ekzekutiv me autonomi të plotë operationale në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe qëllimi themelor i funksionimit të saj është administrimi i ligjeve dhe akteve të tjera juridike që kanë të bëjnë me tatimet në Kosovë.

Legjislacioni Tatimor i aplikueshëm në Kosovë (Ligji Nr. 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/51 mbi Tatimin në të Ardhurat nga Korporatat, Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2004/52 mbi Tatimin në të Ardhurat Personale, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/17 mbi Tatimin në Vlerën e Shtuar), në dispozitat e veta ka përcaktuar se kush mund të jetë obligues tatimor dhe çka mund të jetë objekt i tatimit:

- **Obligues tatimor** sipas ligjeve tatimore në Kosovë mund të jetë çdo person fizik apo juridik, rezident apo jo rezident , burimi i të ardhurave të të cilit është në Kosovë.
- **Objekt i tatimit** për tatimpaguesit jo rezident janë të gjitha të ardhurat e tatueshme nga të hyrat që e kanë burimin në Kosovë.
- **Tatimpagues jo-rezident** është një person apo grup personash që ka vendin e menaxhimit efektiv jashtë Kosovës dhe që nuk është themeluar në Kosovë. Pra, personi jo rezident është thjesht një person që nuk është rezident (banor) në Kosovë.
- Personat jo rezident në Kosovë krijojnë **Njësi të Përhershme që nënkuptohet një vend pune nëpërmjet të cilit personi jo rezident kryen biznes në Kosovë**. Kjo përfshin por nuk kufizohet vetëm në: uzina, degë, përfaqësi, fabrika, punëtori, vend ndërtime etj.
- Personi jo rezident është i obligueshëm që ta informojë Administratën Tatimore të Kosovës për caktimin e përfaqësuesit të tij brenda tri javësh pasi të ketë filluar të krijojë të ardhura ose të ketë blerë pasuri në Kosovë.

Bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/3 mbi Investimet e Huaja në Kosovë, investimet e huaja (organizata afariste që është së paku 25 % në pronësi të investitorëve të huaj) duhet t'u përmbahen ligjeve të njëjta që zbatohen nga organizatat vendase afariste.

Nga ana tjetër, në asnjë rast investimet e huaja nuk mund të tatimohen nga autoritete tatimore në mënyrë më pak të favorshme se organizatat e ngjashme afariste vendase.

Në pajtim me Urdhëresën Administrative Nr. 2002/22 në Zbatim të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/6 mbi Shoqëritë Tregtare është themeluar Zyra për Regjistrimin e Ndërmarrjeve Afariste dhe Emrave Tregtarë të tyre e cila funksionin si Agjenci e Pavarur Ekzekutive nën Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë.

U theksua edhe më lartë se personat jo rezident për të kryer biznes në Kosovë duhet të regjistrojnë një njësi të përhershme përmes së cilës do të realizojnë aktivitetin e tillë.

Një gjë të tillë mund ta bëjnë konform **Udhëzimit Administrativ Nr. 2003/1 i lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në prill të viti 2003** për Fushëveprimin e Zyrës së Regjistrimit dhe Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë. Sipas nenit 2, paragrafit 2.1, pika (e) kjo zyre është përgjegjëse për regjistrimin e njësive – përfaqësive të kompanive të huaja në Kosovë. Ndërkaq, neni 9 i të njëjtit Udhëzim Administrativ thekson të drejtën e Kompanive të Huaja për ta regjistruar një njësi të tillë në Kosovë, duke plotësuar një deklaratë për kohëzgjatjen e paraparë të veprimit në Kosovë, kontratën për marrjen e zyrave me qira apo blerjen e ndërtesave, statutin dhe aktin themelues të kompanisë së huaj, deklarinimin e kapitalit themelor në Kosovë si dhe kriteret e tjera të parapara nga Zyra për Regjistrimin e Bizneseve.

Nga e gjithë kjo, shihet se personat jo rezident duhet t'i përmbahen detyrimeve konform ligjeve dhe akteve të tjera të aplikueshme në Kosovë nëse dëshirojnë të zhvillojnë aktivitet afarist sikurse edhe personat vendor. Megjithatë, jo rrallë hasim raste kur kompanitë e huaja të cilat vijnë me qëllim për të kryer ndonjë biznes në Kosovë përmes pjesëmarrjes në tenderë të ndryshëm që shpallen nga Autoritete të ndryshme kontraktuese apo edhe në forma të tjera, kryejnë shërbimet e veta pa pasur të regjistruar kurrfarë njësie apo përfaqësie të vetën në Kosovë dhe largohen nga këtu pa i shlyer obligimet e veta tatimore për të ardhurat që i krijojnë në Kosovë.

Një fenomen i tillë ka filluar të bëhet dukuri në Kosovë, e që duhet të jetë shumë shqetësues për të gjithë faktorët relevant në Kosovë të cilët në një formë apo tjetrën janë të implikuar në këto procese.

Në fund, përmes kësaj shkrese apeloj tek të gjitha autoritetet publike në Kosovë që me rastin e transaksioneve të ndryshme me kompanitë e huaja t'i kenë parasysh dispozitat e akteve juridike të cekura më lartë, kjo do të thotë që **krahas dokumenteve të tjera që kërkohen nga kompanitë e tilla, për të pasur të drejtë të zhvillimit të çfardo aktiviteti ekonomik apo kryerjes së shërbimeve në Kosovë duhet të ofrojnë edhe certifikatën mbi regjistrimin e Njesisë së Përhershme – Përfaqësisë në Kosovë (një certifikatë e tillë të kërkohet para nënshkrimit të kontratave respektive për kryerjen e aktivitetit afarist).**

Zbatimi korrekt i këtyre dispozitave ligjore është lehtësim për administrimin e tatimeve nga Administrata Tatimore e Kosovës, është në interes të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, është në interes të vet të qytetarëve të Kosovës.

Shpresoj në përkrahjen tuaj!
Me 21.06.2006

Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës

Januz KRASNIQI

